

## “GAROFALO INSPIRES”

### KUSHTET DHE TERMAT E PLOTE

#### SHQIPERI

Pastificio Lucio Garofalo SpA (në vijim referuar si “Organizatori i promovionit” ose “Garofalo”) me seli te regjistruar në adresën Via dei Pastai 42 - 80054 Gragnano (NA), Itali është duke organizuar, këtë Promocion, **të quajtur** “Garofalo Inspires”

Promocioni është i hapur në restorantet e ndodhura në Shqipëri të cilat janë tashmë klient të Pasta Garofalo ose bëhen klient të Pasta Garofalo gjatë Periudhës së promovionit.

Punëmarrësit e Organizatorit të promovionit, dhe familjarët e tyre të drejtpërdrejt, agjentët ose cdonjë që është i lidhur profesionalisht me këtë Promocion nuk ka të drejtë të marrë pjesë.

#### **Blerja e produkteve të Garofalo kërkohet për të hyrë në Promocion.**

Promocioni do të komunikohet tek pjesëmarrësit përmes rrjetit të Përfaqësuesit të Shitjeve Garofalo dhe përmes faqes së internetit të Promocionit [www.garofaloinspires.com](http://www.garofaloinspires.com). Kushtet dhe termat janë në dispozicion tek [www.garofaloinspires.com](http://www.garofaloinspires.com).

Për cdo pyetje ose dyshime në lidhje me promovionin, lutem shkruani tek [garofaloinspires@pastagarofalo.it](mailto:garofaloinspires@pastagarofalo.it).

*Cdo person që regjistrohet ose merrë pjesë në këtë Promocion konsiderohet të ketë pranuar dhe të jetë i lidhur nga termat dhe kushtet e promovionit.*

#### **1. Periudha e promovionit**

Promocioni hapet më datë 20 Maj 2019, ora 00.01 AM deri më datë 24 tetor 2019, ora 23.59 PM.  
Përzgjedhja e fituesit bëhet më/nga datë/a 31 tetor 2019.

#### **2. Regjistrimi dhe pjesëmarrja**

Promocion aktual, i hapur në restorantet në Shqipëri do të reklamohet përmes faqes së internetit të promovionit [www.garofaloinspires.com](http://www.garofaloinspires.com) dhe përmes rrjetit të përfaqësimit të shitjeve Garofalo.

Për t’u konsideruar i përshtatshëm për regjistrim, restorantet do të jenë (ose bëhen) klientë të Garofalo, dhe të përdorin Pasta Garofalo për të krijuar receta gatimi, që do të shtohen në menun e tyre.

Më konkretisht, për t’u regjistruar restorantet duhet të:

- vizitojnë faqen [www.garofaloinspires.com](http://www.garofaloinspires.com) dhe të hyjnë në seksionin e dedikuar për Shqipërinë (përveç kur ata drejtohen automatikisht)
- shkarkojnë (pa kryer regjistrimin) “Modelin e Broshures” të disponueshme në PDF\* dhe të ndjekin udhëzimet me kusht që të realizojnë një broshurë me recetat e tyre të gatimit, për t’u shtuar në menut e tyre: PDF duhet të plotësohet (me shkrim dore ose në mënyrë elektronike) me emrin dhe një përshkrim të shkurtër të recetës së tyre.
- gatuajë dhe vendos në pjatë recetën e tyre të re të gatimit;
- bëj një fotografi duke treguar mënyrë si mund të shërbehet: fotografia duhet të tregoj qartë pjatën, të përgatitur dhe të shërbyer, si dhe broshurën, të realizuar dhe printuar si më sipër.
- drejtohet tek [www.garofaloinspires.com](http://www.garofaloinspires.com) dhe regjistrohet, duke paraqitur cdo të dhënë personale dhe të restorantit të kërkuar, informacionin lidhur me recetën e tyre të gatimit. Për të përfunduar regjistrimin, restorantet duhet të ngarkojnë në faqen e internetit fotografimin e tyre (që tregon pjatën e gatuar dhe broshurën e printuar, sic shpjegohet më sipër).

\*) Lutem vini re se modeli i broshurës mund të jetë gjithashtu e disponueshme në formë të printuar, nga përfaqësuesit e shitjeve të Garofalo: në rast se preferojnë ta bëjnë këtë, restorantet do të lejohen të plotësojnë formularin me shkrim dore, por në cdo rast regjistrimi i pjesëmarrjes duhet të paraqitet vetëm në faqen e internetit, sic përshkruet në paragrafin më sipër.

**ME RENDESI: përdorimi i Pasta Garofalo në pjatat e gatimit përbën një kërkesë thelbësore për pranimin në promocion. Në cdo kohë, Organizatori i promocionit rezervon të drejtën për të verifikuar vlefshmërinë e regjistrimeve dhe pjesëmarrësve, duke përfshirë identitetin e pjesëmarrësve, moshën dhe vendbanimin, si dhe ekzistencën e ndonjë porosie të dhënë nga restorantet pjesëmarrëse, si dhe të përjashtojë cdo pjesëmarrës i cili shkel termat dhe kushtet ose ngatërrohet me procesin e regjistrimit në Promocion.**

Të gjitha regjistrimet e paraqitura nga restorantet pjesëmarrëse do të moderohen dhe, nëse vlerësohet, do të jenë të disponueshme në faqen e promocionit [www.garofaloinspires.com](http://www.garofaloinspires.com).

Lutem vini re se:

- Është në përgjegjësinë e cdo pjesëmarrësi për të marrë lejen e punëdhënësit të tyre kur shihet e domosdoshme për t'u regjistruar. Sapo të regjistrohet, cdo pjesëmarrës konsiderohet se ka marrë, ose nuk nuk është e kërkueshme, një leje e tillë.
- 1 regjistrim për person dhe restorant

### 3. PËRZGJEDHJA E FITUSVE

Të gjitha regjistrimet e paraqitura do të vlerësohet nga një Juri Vlerësuesish të zgjedhur nga Organizatori dhe i mbikqyrur nga një subjekt vlerësues i pavarur. Recetat e gatimit do të vlerësohen bazuar në kriteret vijuese:

- Elementët përbërës të përdorur në recetën e gatimit;
- Originaliteti i recetës së gatimit;
- Fotografi

Cdo anëtar i jurisë do të vlerësojë recetën e gatimit dhe caktojë pikë për cdo nga kriteret e sipërmendura. Shuma e cdo pike të caktuar për secilin pjesëmarrës do të përdoret për të zgjedhur 1 Fituesin.

### 4. CMIMET

**Fitues do t'i akordohet një** Udhëtim në Itali për 1 person, për të marrë pjesë në një Klasë Gatimi me Shefin e kuzhinës Niko Romito (vlera e përafërt: 2.500 €).

Detajet e Cmimit:

Fituesi do të ketë mundësinë për të marrë pjesë në një Klasë Gatimi me Shefin Niko Romito, që do të zhvillohet në Itali, në "Akademinë Niko Romito" me adresë në Castel di Sangro (AQ) ndërmjet datave 24 dhe 29 Nëntor 2019 (data mund të jetë subjekt i ndryshimit, në varësi të mundësisë se Shefit, por do të konfirmohen të paktën 7 më përpara tek fituesi).

Cmimet përfshijnë:

- Biletat e kthimit vetëm për fituesin/it, në klasën ekonomike, me nisje në aeroportet nderkombetare afër vendbanimit të fituesit/esve dhe mbërritje në Romë;
- Transportin nga Roma në adresën e Klasës së Gatimit;
- Shef Ndihmës të Dedikuar në Anglisht
- 4 ditë Trajnime Profesionale në Akademinë Niko Romito (27 orë)
- 5 nete qëndrimi ne Hotel te perzgjedhur.
- 4 darka në Restarontin e Studentëve të Akademisë Niko Romito - 3 Yje Michelin
- 1 mëngjes
- 1 drekë në Restorantin Niko Romito – 3 Yje Michelin
- Certifikata e pjesëmarrjes do të lëshohet tek cdo pjesëmarrës

Cmimi nuk përfshin:

- Transportin në aeroportin e nisjes;
- Cdo shpenzim shtesë ose personal;

Lutem vini re se:

- Cdo fitues i kërkohet që të deklarojë dhe të paguajë në mënyrë të pavarur cdo taksë dhe tarifë të aplikueshme që cmimi sjell si pasojë e juridiksionit të fituesit(esve).
- Asnjë cmim nuk është i transferueshëm, dhe asnjë cmim nuk do të pretendohet në vlerë monetare ose të ndryshojë në një cmim tjetër ose marrëveshje. Megjithatë, në rast të rrethanave të paparashikuara ose shkaqeve jashtë kontrollit të arsyeshëm të Organizatorit të promocionit, Organizatori i promocionit rezervon të drejtën të ndryshojë, heq dorë ose zëvendësojë cmimin për një cmim ose marrëveshje alternative.

## 5. NJOFTIMI I FITUESVE

Fituesit do të kontaktohen me email brenda 5 ditësh pune nga përzgjedhja e fituesve dhe do t'ju kërkohet të **përgjigjen brenda 10 ditëve kalendarike duke paraqitur të dhënat në tërësi të Shefit dhe një kopje të dokumentit të tij/saj të identifikimit**. Nëse një pjesëmarrës nuk mund të tërheq cmimin ose dështon të përgjigjet brenda kohës së përcaktuar, pjesëmarrësi do të përjashtohet, dhe cmimi do t'i ofrohet vendit rezervë. Ky proces do të vijojë deri kur personat rezervë të jenë të mundshëm. Organizatori i promocionit nuk mban asnjë përgjegjësi në rast se një restorant nuk mund të kontaktohet për cfaredo arsye.

## 6. FSHEHTESIA E INFORMACIONIT

Të dhënat personale të dhëna nga dhe lidhur me pjesëmarrësit do të mbahen dhe përdoren në përputhje me Politikën e Fshehtësisë të Organizatorit të promocionit nga Organizatori i promocionit, dhe grupi i saj i shoqërive, furnizuesit dhe kontraktorët në masën e domosdoshme për të kryer dhe administruar këtë Promocion. Politika e Fshehtësisë mund të lexohet këtu: [www.garofaloinspires.com](http://www.garofaloinspires.com)

Të dhënat personale nuk do t'i kalohen një marrësi të tretë, pa pëlqimin paraprak të subjektit dhe nuk do t'i nënshtrohen transferimit ndërkombëtar.

Subjekti ka të drejtën e aksesit, bllokimit, korrigjimit ose fshirjes së të dhënave personale që Organizatori i promocionit ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrojë çdo të drejtë tjetër që i njihet nga legjislacioni në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Duke marrë pjesë në Promocionin, pjesëmarrësit konsiderohen se pranojnë dhe janë të lidhur nga këto terma dhe kushte dhe të kenë dhënë miratimin e transferimit dhe përpunimit të të dhënave personale nga Organizatori i promocionit për qëllimin e këtij Promocioni në përputhje me Politikën e Fshehtësisë së Organizatorit të promocionit.

Pjesëmarrësit do të ftohen për t'u zgjedhur në marrjen e komunikimeve më tej nga Organizatori i promocionit dhe partnerët e zgjedhur. Duke zgjedhur kete kusht, pjesëmarrësit miratojnë për të marrë me adresë elektronike email dhe/ose komunikim tregtar në lidhje me produktet, shërbimet dhe eventet e Organizatorit të promocionit. Kjo nuk do të ndikojë në mundësitë e një pjesëmarrësi për të fituar.

## 7. KËRKESAT NË MATERIALE

- a. Cdo material i paraqitur në Promocion ose i ngarkuar në faqen [www.garofaloinspires.com](http://www.garofaloinspires.com) nuk duhet të përmbajë gjuhë ofenduese, diskrimine raciale ose fetare, dhunë, akte seksuale, sulme ndaj njerezve ose organizatave ose akte të pahijshme të tjera ose përmbajtje të papërshtatshme. Të gjitha materialet e paraqitura dhe të ngarkuara do të rishikohen përpara publikimit.
- b. Organizatori i promocionit rezervon të drejtën të moderojë, refuzojë ose përjashtojë cdo prezantim ose material, përpara ose pas publikimit, i cili, në diskrecionin e tij vlerëson se është i pahijshëm, ofendues ose i papërshtatshëm ose është ndryshe në kundërshtim me letrën dhe frymën e Promocionit ose dëmton potencialisht Organizatorin e Promocionit, Promocionin, ose cdo imazh dhe reputacion të palëve të treta gjithashtu.
- c. Të gjitha materialet e paraqitura dhe/ose të ngarkuara do të jenë punime orgjinale të krijuara nga një pjesëmarrës dhe do të moderohen nga Organizatori i promocionit. Duke marrë pjesë në Promocion secili pjesëmarrës konfirmon se:

- Materialet e paraqitura nga pjesëmarrësi nuk shkel të drejta të ndonjë të drejtë autori të shoqërive ose personave të tjerë, marka, të drejta morale, të drejtën e fshehtësisë, ose të drejta të tjera pronësisë intelektuale;
  - Asnjë person ose shoqëri nuk ka të drejta, tituj ose interesa në material;
  - Pjesëmarrësit nuk kanë në asnjë mënyrë transferuar, licensuar, disponuar ose ndryshe vendosur peng ndonjë të drejtë që i lejon ata të paraqesin materialet;
  - Pjesëmarrësi ka marrë të gjitha lehtësirat dhe miratimet të palëve të treta të domosdoshme për të lejuar paraqitjen dhe ekspozimin e materialit në mënyrën e parashikuar në këto kushte dhe terma pa kompensime shtesë;
  - Materiali nuk përmban përmbajtje të kundraligjshme ose që janë të ndaluara me ligj ose përmbajtje kundër ligjeve ose rregulloreve të vendit ku ky Promocioni do të kryhet dhe/ose juridiksionin ku materiali u krijua dhe/ose u paraqit në Promocion.
- d. Materialet e ngarkuara në faqen [www.garofaloinspires.com](http://www.garofaloinspires.com) duhet të jetë e formatit png / jpg dhe nuk duhet të kalojë 10 MB në madhësi.  
Materialet mund të paraqiten vetëm elektronikisht. Të gjitha materialet e tjera nuk do të merren në konsideratë. Materialet e paraqitura nuk do të kthehen.
- e. Përvec kësaj, materialet e ngarkuara nuk do të:
- Përfshijnë njerëz nën moshën 18 vjeç;
  - Përfshijnë njerëz të njohur, ndryshe nga pjesëmarrësit, vetëm kur miratimi i tyre për ngarkimin e fotografisë është marrë me shkrim;
  - Përfshijë marka tregtare, marka shërbimi, emra shoqërisht tregtare ose të drejta të tjera të pronësisë intelektuale;
  - Të shkelë të drejta e fshehtësisë ose integritetin ose përshkruajë një person në një situatë jo të këndshme ose dëshpëruese.
- f. Një pjesëmarrës do të jetë përgjegjës për cdo pagesë, shpenzim ose humbje të shkakuar nga Organizatori i promocionit si pasojë e shkeljes së kërkesave nga pjesëmarrësi në lidhje me materialet nëse Organizatori i promocionit bëhet subjekt i denoncimeve, pretendimeve, veprimeve ose procedimeve ligjore si rrjedhojë e shkeljes së këtyre termave dhe kushteve.
- g. Të gjitha materialet e paraqitura në Promocion bëhen pasuri e Organizatorit të promocionit. Organizatori i promocionit mund të përdorë materialet sipas diskrecionit të tij në cdo mënyrë pa patur detyrimin për të paguar shpërblime tek pjesëmarrësit për përdorimin e materialit.
- h. Cdo foto dhe të gjitha materialet e paraqitura, si dhe emrat e fituesve, mund të përdoren sipas diskrecionit të Organizatorit të promocionit, për promovimin e Promocionit ose cdo produkti ose shërbimi të fabrikuar, furnizuar ose ofruar nga Organizatori i promocionit dhe i lidhur me objektin e këtij Promocioni.

## 8. Kushte të përgjithshme

- Informacion se si të regjistrososh pjesë të formave të këtyre kushteve. Duke marrë pjesë, ju jeni dakord t'i bindeni këtyre kushteve.
- Organizatori i promocionit nuk mund të pranojë asnjë përgjegjësi për ndonjë dëm, humbje, dëmtim (duke përfshirë humbje indirekte ose të prejardhur) të pësuar nga cdo regjistruar në Promocion ose si rezultat i pranimit të cmimit. Megjithatë, asgjë nuk do të përjashtojë përgjegjësinë e Organizatorit të promocionit për dëmtimin personal ose vdekjen si rrjedhojë e neglizhencës.
- Organizatori i promocionit nuk është përgjegjës për ndonjë problem teknik ose gabim njerëzor që mund të rezultojë në një regjistrim, paraqitje ose regjistrim që nuk është marrë ose ka humbur ose dëmtur ose për cdo shkatërrim ose ndryshim të tyre, ose akses i paautorizuar në faqen e internetit.
- Vendimet e Organizatorit të promocionit në lidhje me cdo aspekt të këtij Organizatori i promocionit është përfundimtar dhe asnjë korrespondencë nuk do të përfshihet në të. Organizatori i promocionit mund të refuzojë të jap një cmim tek ndonjë person, për cdo arsye.
- Organizatori i promocionit rezervon të drejtën të heq dorë, ndryshojë, anuloj ose pezulloj një element të cmimit nëse, për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të tij, ai element nuk është më i mundshëm. Organizatori i promocionit nuk do të jetë përgjegjës për, ose i detyruar tek ndonjë fitues, nëse e gjithë ose pjesë e cmimit nuk

është e disponueshme ose duhet të ndryshojë ose anulohet për cdo arsye. Në rast të rrethanave të paparashikuara, Organizatori i promovimit rezervon të drejtën të zëvendësojë një cmim ose një element të cmimit për një vlerë alternative të barabartë ose më të lartë.

- Organizatori i promovimit nuk është përgjegjës për veprimet e ndonjë palë të tretë.
- Ky promovim është subjekt i të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme.
- Nëse një veprim, lëshim, ngjarje ose rrethanë ndodh dhe përtej kontrollit të arsyeshëm të Organizatorit të promovimit dhe që pengon Organizatorin e promovimit nga përmbushja e këtyre termave dhe kushteve, Organizatori i promovimit nuk do të jetë përgjegjës për asnjë dështim për të kryer ose vonuar kryerjen e detyrimeve të tij.
- Nëse ky Promovim është penguar në cdo mënyrë ose nuk është i mundshëm për t'u kryer si i parashikuar në mënyrë të arsyeshme për shkak të cdo arsye përtej kontrollit të arsyeshëm të Organizatorit të promovimit duke përfshirë luftën, terrorizmin, gjëndjen e emergjencës ose shkatërrimit (duke përfshirë shkatërrimi i natyrës), infektuar nga virus kompjuterik, cimka, ngatërresa, ndërhyrje e paautorizuar, mosfukcion teknik ose cdo shkat tjetër që prish ose ndikon administrimin, sigurinë, paanësinë, integritetin ose kryerjen sic duhet të këtij Promovimi, Organizatori i promovimit rezervon të drejtën, në diskrecionin e tij, në masën e lejuar nga ligji (a) të përjashtojë cdo regjistruer; ose (b) subjekt i ndonjë udhëzimi me shkrim nga një autoritet rregullator, për të ndryshuar, pezulluar, përfunduar ose anuluar këtë Promovim, sipas rastit.
- Organizatori i promovimit rezervon të drejtën për të verifikuar vlefshmërinë e regjistrimeve dhe rezervon të drejtën për të përjashtuar cdo regjistruer që ngatërrohet në procesin e regjistrimit ose për paraqitjen e një regjistrimi që nuk është në përputhje me këto kushte, ose nëse regjistruesi është i përfshirë në cdo sjellje të kundraligjshme dhe të papërshtatshme të konsideruar se rrezikojnë realizimin e drejtë dhe të përshtatshëm të Promovimit. Të drejtat ligjore të Organizatorit të promovimit për të rikuperuar dëme ose kompensime të tjera nga një shkelës janë të rezervuara.

**Termet dhe Kushtet e plota janë të disponueshme në faqen: [www.garofaloinspires.com](http://www.garofaloinspires.com)**

**Promovimi do të rregullohet nga Ligjet e Shqipërisë**